



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 10
Prishtinë, më 28 prill 2011

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 28 PRILL 2011

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 22 prill 2011,
4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-010 për noterinë,
5. Projektligji për shërbimet e sigurisë private,
6. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L -123 për shoqëritë tregtare,
7. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim,
8. Projektligji për gjendjen civile,
9. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme,
10. Plani i veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2011,
11. Miratimi i Rezolutës për angazhimin e Kosovës drejt integritetit në Bashkimin Evropian

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ismet Beqiri, Rexhep Selimi, Daut Haradinaj, Bekim Haxhiu, Nait Hasani, Haki Demolli, Aurora Bakalli, Nijazi Idrizi, Sabri Hamiti, kryeministri Hashim Thaçi dhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, që janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Lutfi Haziri parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me rishikimin e Aneksit 3 për procesin e decentralizimit nga Pakoja e Ahtisarit.

Kryeministri Hashim Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Haziri.

Deputeti Lutfi Haziri parashtroi pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri lidhur me kërkesat konkrete të palës kosovare gjatë bisedimeve me palën serbe për energji dhe lëvizje të lirë.

Zëvendëskryeministrja Tahiri iu përgjigj pyetjes së deputetit Haziri.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 22 prill 2011

Kuvendi miratoi pa vërejtje Procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 22 prill 2011.

4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-010 për noterinë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-010 për noterinë.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** tha se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për noterinë është në harmoni të plotë me legjislacionin evropian. Ndryshimet dhe plotësimet e paraqitura në këtë projektligj janë rezultat i asaj se Ligji në fuqi nuk është i harmonizuar plotësisht me legjislacionin evropian nga kjo fushë.

Në vazhdim, tha se ky projektligj do të krijojë përparësi për një ambient afarist të avancuar në Kosovë, ndërsa vlerësoi punën e paraardhësve të tij në drejtim të përpilimit të legjislacionit që ka të bëjë me këtë ministri.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-010 për noterinë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Legjislacion, Arben Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Halit Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit

Parlamentar Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Rashiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Duda Balje, si dhe ministri Hajredin Kuçi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----76,
Kundër-----6,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-010 për noterinë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Projektligji për shërbimet e sigurisë private

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për shërbimet e sigurisë private

Ministri **Bajram Rexhepi** tha se nevoja për Projektligjin për shërbimet e sigurisë private është e madhe. Dispozitat e këtij Projektligji nuk do të zbatohen në aktivitetet të cilat rregullohen me Ligjin për Policinë dhe aktivitetet e tjera me të cilat janë të ngarkuara institucionet shtetërore.

Në vazhdim, tha se ky projektligj adreson çështjet që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarive private të sigurisë, standardet profesionale, trajnimet e punëtorëve, themelimin e Komisionit të Ankesave për Siguri Private, mbajtjen e evidencave etj.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për shërbimet e sigurisë private.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, deputeti Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Anton Quni, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Marinković, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Rasim Demiri, si dhe deputetët: Haki Demolli, Imri Ahmeti, Hykmete Bajrami, Ardian Gjini, dhe ministri Bajram Rexhepi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----79,
Kundër-----0,

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për shërbimet e sigurisë private.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L -123 për shoqëritë tregtare

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L -123 për shoqëritë tregtare.

Ministrja **Mimoza Kusari-Lila** tha se ky Projektligj është harmonizuar me ligjet tjera në fuqi.

Në vazhdim, tha se ndryshimet themelore në këtë projektligj kanë të bëjnë me heqjen e tatimeve për regjistrimin fillestar të biznesit, përcaktimin e të drejtave të palëve të pakënaqura, heqjen e obligimeve për raporte vjetore për bizneset etj.

Në fund, duke theksuar rëndësinë që ka ky projektligj, ajo kërkoi miratimin në parim nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L -123 për shoqëritë tregtare.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Rashiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Fikrim Damka, si dhe deputetët: Lutfi Zharku, Ardian Gjini, Visar Ymeri, Sabri Hamiti dhe ministrja Mimoza Kusari-Lila, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 46,

Kundër-----44,

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L -123 për shoqëritë tregtare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregullore dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim.

Ministrja **Mimoza Kusari-Lila** tha se në funksion të përmbushjes së objektivave që dalin nga direktiva më e re e legjislacionit evropian nga kjo fushë, kemi iniciuar ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim.

Në fund, ajo kërkoi miratimin në parim të këtij projektligji nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe në emër Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Enis Kervan, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 50,
Kundër-----46,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Projektligji për gjendjen civile

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për gjendjen civile.

Ministri **Bajram Rexhepi** tha se Projektligji për gjendjen civile adreson fushat thelbësore të regjistrimit civil në pajtim me praktikat ndërkombëtare.

Në vazhdim, tha se në përpilimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë përfaqësues të instancave ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, si ZCN-ja, UNHCR-ja etj, rekomandimet e të cilëve janë inkorporuar në tekstin e projektligjit. Projektligji përmban 11 kapituj me 67 nene dhe ka implikime buxhetore të përballueshme për MPB-në, theksoi ministri Rexhepi dhe kërkoi miratimin, në parim, të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për gjendjen civile.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ganimete Musliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Vjollca Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Afrim Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Marinković, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Armend Zemaj, Hydajet Hyseni dhe ministri Bajram Rexhepi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----81,
Kundër-----5,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për gjendjen civile.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme.

Ministrja **Mimoza Kusari-Lila** tha se arsyeshmëria për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme qëndron në krijimin e kushteve në mënyrë që ligji të jetë i zbatueshëm në tërësi, pasi që disa nene të ligjit në fuqi janë në kolizion me ligjet tjera, siç është rasti me Ligjin për Inspektionin e Tregut.

Në fund, ajo kërkoi miratimin, në parim, të këtij projektligji nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Rashiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Sala Berisha-

Shala, Arben Gashi, Ismet Beqiri, Lutfi Zharku dhe ministrja Mimoza Kusari-Lila, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 51,
Kundër-----33,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Plani i veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2011

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Integritet Evropian që para deputetëve të paraqet Planin e veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2011.

Deputeti **Lutfi Haziri** tha se Komisioni për Integritet Evropian, në bazë të Raportit të progresit të Komisionit Evropian për Republikën e Kosovës për vitin 2010, ka përgatitur Planin e veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2011, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Në vazhdim, tha se për dallim nga dy vitet e kaluara, Plani i veprimit i këtij viti është përqendruar në prioritetet, si në përmbushjen e kriterëve politike që mundëson funksionimin e institucioneve të cilat garantojnë sundimin e ligjit, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe janë marrë parasysh vërejtjet e ngritura në mandatin e kaluar nga komisionet tjera për thjeshtimin e planit. Ai më tej vlerësoi ndihmën e ofruar nga misioni i OSBE-së dhe nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.

Në fund, deputeti Haziri kërkoi miratimin e Planit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2011.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin e Planit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2011.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë Plan të veprimit dhanë: në emër Grupit Parlamentar të PDK-së, Blerta Deliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Blerim Shala, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Amir Ahmeti, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Milosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Zenun Pajaziti, Sabri Hamiti, Ardian Gjini, Arben Gashi dhe Muhamet Mustafa, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij Plani.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 76,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Planin e veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2011.

11. Miratimi i Rezolutës për angazhimin e Kosovës drejt integritetit në Bashkimin Evropian

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Integritet Evropian, që në cilësinë e propozuesit të paraqet para deputetëve Rezolutën për angazhimin e Kosovës drejt integritetit në Bashkimin Evropian.

Deputeti **Lutfi Haziri** në emër të Komisioni për Integritet Evropian, paraqiti arsyeshmërinë dhe tekstin e propozuar të Rezolutës për angazhimin e Kosovës drejt integritetit në Bashkimin Evropian.

Ai kërkoi miratimin e Rezolutës për angazhimin e Kosovës drejt integritetit në Bashkimin Evropian.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin e Propozim-Rezolutës për angazhimin e Kosovës drejt integritetit në Bashkimin Evropian.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim –Rezolutë dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Blerta Deliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Milosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Alma Lama, Zenun Pajaziti dhe Lutfi Haziri, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Propozim-Rezolutës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 73,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash nxori këtë:

R E Z O L U T Ë

Për angazhimin e Republikës së Kosovës drejt integritetit në Bashkimin Evropian

Duke marrë parasysh pajtimin e plotë në Republikën e Kosovës për integritetin në Bashkimin Evropian,

Duke i pranuar qëllimet, vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar Bashkimi Evropian,

Duke synuar ndërtimin e një shteti të bazuar në parimet e lirisë, të demokracisë, të respektimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, si dhe në sundimin e ligjit,

Duke njohur Kriteret e Kopenhagës 1993 dhe Kriteret e Madridit 1995, si kritere kryesore për anëtarësimin në Bashkimin Evropian,

Duke shprehur gatishmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës për të vepruar në bazë të standardeve evropiane, si parakusht për anëtarësim në Bashkimin Evropian,

Duke shprehur përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për zyrtarizmin e marrëdhënieve me Bashkimin Evropian dhe duke qenë të vetëdijshëm mbi sfidat që na presin për arritjen e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian,

Duke vlerësuar përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për të zgjeruar më tej bashkëpunimin me institucionet evropiane në Republikën e Kosovës,

Duke vlerësuar bashkëpunimin ndërparlamentar ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit Evropian dhe duke u zotuar për bashkëpunim më të ngushtë,

Duke marrë parasysh arritjet e deritashme nga Mekanizmi Përcjellës i Stabilizim-Asociimit dhe Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit,

Duke marrë parasysh gjetjet e Raporteve vjetore të Progresit të Komisionit Evropian për Republikën e Kosovës, si dhe nevojën për të adresuar sfidat dhe rekomandimet e paraqitura në këto raporte,

Duke u thirrur në Planin e veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Planin e veprimit për Partneritet Evropian të Kosovës,

Kuvendi i Republikës së Kosovës

1. Rikonfirmon zotimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për përmbushjen e kriterëve dhe të standardeve të kërkuara për integrim në Bashkimin Evropian;
2. Rikonfirmon gatishmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës për thellimin e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian me synim të fuqizimit të pozitës së Kosovës në proceset e integritetit evropian;
3. Mirëpret rezolutën e Parlamentit Evropian të 9 korrikut 2010 që fton të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian të njohin pavarësinë e Republikës së Kosovës;
4. Zotohet se do të intensifikojë përpjekjet për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Dialogu i Procesit të Stabilizim Asociimit me synimin kryesor nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit;
5. Shpreh përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për arritjen e kriterëve politike, ekonomike dhe standardeve evropiane;

6. Konsideron si prioritetet kryesore përmbushjen e kërkesave për procesin e liberalizimit të vizave; forcimin e marrëdhënieve tregtare me Bashkimin Evropian në të mirë të prodhuesve vendorë; përmirësimin e bashkëpunimit rajonal; forcimin e sundimit të ligjit dhe harmonizimin e legjislacionit me *acquis communautaire* dhe zbatimin e tij sipas kërkesave të Bashkimit Evropian; si dhe reformimin e administratës publike dhe të Kuvendit bazuar në parimin e një administrate publike efektive pa ndërhyrje politike;
7. Shpreh gatishmërinë për bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit Evropian në të gjitha nivelet;
8. Kërkon nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që të koordinojnë përpjekjet e tyre drejt përmbushjes së rekomandimeve të dala nga Raportet vjetore të Progresit për Republikën e Kosovës, dhe përfshirjen e veprimeve konkrete në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, Buxhetin vjetor të Republikës së Kosovës dhe agjendën vjetore legjislative;
9. Kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që rregullisht dhe në mënyrë përmbajtjesore të njoftojë Kuvendin e Republikës së Kosovës mbi ecurinë e masave të ndërmarra për realizimin e prioriteteve të sipërpërmendura;
10. Përkushtohet për realizimin dhe bënë mbikëqyrjen e procesit të zbatimit të obligimeve të sipërpërmendura nga institucionet e Republikës së Kosovës me përfshirjen e shoqërisë civile.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:00.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale